



Prishtinë, 12.07.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1017_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitat e Nenit 10.4 të Kodit të Rrjetit- Dispozitat e përgjithshme,
- Dispozitat e Nenit 10 dhe 11 të Doracakut të raportimit për sektorin e energjisë,
- Kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Raportit të Derogimeve për Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut të datës 20.06.2018 të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT),

në seancën e mbajtur me datë 12.07.2018, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A. për **Derogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut** si në shtojcë të këtij vendimi.
- II. Dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut mbesin në fuqi.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 20.06.2018 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A., për derogim në zbatimin e disa dispozitave nga Kodi i Rrjetit dhe Rregullat e Tregut.
- KOSTT në kërkesën e vet ka sqaruar arsyet e kërkesës për derogim të dispozitave ligjore të Kodit të Rrjetit, që kanë të bëjnë me reduktimin nga nënfrekuenca sipas kodit operativ, dhe ka kërkuar derogim (shtyrje të afatit të zbatimit të dispozitave) të Kodit të Rrjetit deri më 31.12.2018 (lejuar).
- Poashtu ka kërkuar derogim në zbatimin e dispozitave të Rregullave të Tregut, në lidhje me alokimin dhe tregtimin e kapaciteteve interkonektive dhe për nominimet interkonektive për një periudhë derisa KOSTT të fillojë operimin si Zonë Rregulluese/Bllok Rregullues (lejuar deri



më 31.12.2018).


- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të Raportit të Derogimeve të dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut ka vendosur si në diapozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi së bashku me Raportin e derogimeve me afatet e lejuara iu dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të ZRRE-së.